



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE
DEKANI

Nr. 1214 Prot.

Shkodër, me 09.11.2025

Lënda: Dërgohet vendimi i komisionit ad-hoc për vlerësimin e dosjes së pedagogut me kohë të plotë.

Degës Burimeve Njerëzore

Bashkëngjitur po ju dërgojmë vendimin e komisionit ad-hoc të ngritur pranë Departamentit të Fizikës për vlerësimin e dosjes së kandidatit për pedagog me kohë të plotë me kartë ID, i cili shpallet jo fitues.

DEKANI

Prof.as.Dr. Rrok SMAJLAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
DEPARTAMENTI I FIZIKËS

Nr 70 Prot.

Shkodër, më 29.10.2025

Proces- Verbal

I mbajtur më datë 29.10.2025, nga komisioni ad-hoc i ngritur me shkresën nr. 1120 Prot., datë 22.10.2025, të Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, Prof. Asoc. Dr. Rrok Smajlaj, për zhvillimin e konkursit të pranimit për pedagog me kohë të plotë pranë Departamentit të Fizikës.

Në përbërje të komisionit:

- Përfaqësuese e Dekanit: Dr. Nevila Bushati, sipas shkresës nr. 1120 Prot., datë 22.10.2025.
- Përfaqësuese e Rektorit: Prof. Eliana Laçe, sipas Vendimit nr. 118, datë 22.10.2025.

Konkursi është shpallur në Agjencinë e Prokurimit Publik, në njoftimin me nr. prot. 2982, datë 23.09.2025.

Komisioni, pasi ri-shqyrtoi dosjen e kandidatit të vetëm të paraqitur për këtë vend pune, konstatoi një lapsus në llogaritjen e notës mesatare të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve për kandidatin me nr. ID K10804086V.

Në vlerësimin fillestar, mesataret ishin llogaritur si mesatare aritmetike, ndërsa, sipas Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, datë 20.02.2009, nr. prot. 1088/2, duhej të llogariteshin si mesatare të ponderuara.


Pas rillogaritjes:

- Mesatarja e ponderuar e nivelit "Bachelor" rezultoi 7.41;
- Mesatarja e ponderuar e nivelit "Master Shkencor" rezultoi 8.06.

Në vijim, komisioni shqyrtoi dosjen sipas kriterit të notës mesatare të ponderuar të grup-lëndëve, ku, sipas njoftimit të shpallur më datë 23.09.2025, kërkohet që kjo notë të mos jetë më e ulët se 8.5. Nga verifikimi, nota mesatare e grup-lëndëve rezultoi 7.43, pra më e ulët se kriteri i përcaktuar në shpallje.

1. Kandidati me nr. ID K10804086V, i paraqitur si kandidati i vetëm për vendin vakant të shpallur nga Departamenti i Fizikës, skualifikohet nga fazat e mëtejshme të konkurimit, pasi nota mesatare e grup-lëndëve (7.43) është më e ulët se kriteri i përcaktuar në shpalljen e konkursit (≥ 8.5).
2. Kandidati do të njoftohet me emailin e deklaruar në dokumentacionin e paraqitur për këtë procedurë, në lidhje me vendimin e komisionit.
3. Ky proces-verbal dhe vendimi i komisionit i përcillen:
 - o Dekanatit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës,
 - o Degës së Burimeve Njerëzore,
 - o dhe Rektoratit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", për ndjekjen e procedurave të mëtejshme sipas rregulloreve në fuqi.

KOMISIONI

Dr. Klotilda Nikaj	(Kryetare)	
Dr. Edmond Lukaj	(Anëtar)	
Msc.Senada Jubica	(Anëtare)	
Dr. Nevila Bushati	(Përfaqësuese e Dekanit)	
Prof. Ass Eliana Laçe	(Përfaqësues i Rektorit)	